



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**  
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksioni i pallatit Nr. 1300”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45210000-2;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9,073,984.00 (nëntë million e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,

*formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e fondit limit, 0,4x9,073,984.00= 3,629,593.60 (tre milion e gjashtëqind e njëzetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre.6) lekë Pa TVSH**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 ”Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, in dryshuar.

2.2.3 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit si dhe të shoqëruara me AktEkspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

*Shënim:* Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 2 722 195.2 (dy milion e shtatëqind e njëzetë e dy mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë.2) lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet konkretisht : 9 073 984 (Nëntë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër ) lekë pa TVSH.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

**Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

**Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me :**

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

**Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion;
- Akt kolaudimi objekti.

*Në rast të bashkimit të operatorëve Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për kontratat e realizuar si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht duhet të paraqesi edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili antar i BOE – së.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të hapura të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar referuar pikës 2a të Kreut II të Vendimit Nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetar në procedurat e prokurimit publik”, ndaj për të rritur konkurrencën si dhe për t’ju dhënë mundësi edhe operatorëve ekonomikë të vegjël, por të aftë për ekzekutimin e këtyre kontratave është përzgjedhur kufiri minimal për kontratat e ngjashme.

Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”, ndaj nëpërmejt dokumentacionit të kërkuar AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Gjithashtu paragrafi 2 i pikës 3 të nenit 88 të VKM – së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikon se ” Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

---

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :**

NP – 1 A Punime gërmimi në tokë

NP – 2 A Ndërtime civile dhe industriale

NP – 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje, fasada

NP – 4 A Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale

#### **Për punimet speciale të ndërtimit**

NS – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

NS – 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”si dhe Ligjit Nr. 10 081, datë 23.02.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyrura të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësit tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	<b><i>(Punime gjurmimi në tokë)</i></b>  Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore	Gjurmim dheu themele e plinta me b> 2 m, ekskavator me goma 0.25 m3, shkarkimi ne toke	A (0-20 milion)	49 763.84

NP-2	<p><b><i>(Ndërtime civile e industriale)</i></b></p> <p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.</p> <p>Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadium, godina industrial, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonje punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membana, kupola, depozita të varura, silos dhe ndërtime të larta me strukture me karakteristika të veçanta e komplekse.</p>	<p>Punimet e sek 2. PUNIME BETON DHE B/A + 3. PUNIME HEKUR BETONI</p>	A (0-20 milion)	268 467.03
NP – 3	<p><b><i>( Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasadash.)</i></b></p> <p>Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i</p>	Përfshihen të gjitha punimet	A (0-20 milion)	8 641 888.5

	<p>punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje</p>			
NP - 4	<p><b><i>(Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.)</i></b>  Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve</p>	<p>Punimet e sek 1.  Zerat Prishje trotuari ekzistues + Prishje shtresa betoni 6.  INSTALIME  HIDRO-SANITARE  DHE NGROHJE + 7.  NENSHTRESA  DHE SHTRESA NE  TERRITORIN E  NDERTESAVE+ 8.  PUNIME DHEU+ 9.  UJESJELLES DHE  KANALIZIM I  JASHEM+ 10.  PUNIME  SHTRESASH 2+ 11.  PUNIME  SHTRESASH+ 12.  PRODHIMI I  MATERIALEVE TE  NDERTIMIT+ An06</p>	<p>A (0-20 milion)</p>	<p>1 888 779.9</p>



	në rrejtin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.			
NS – 1	<b><i>(Punime për prishjen e ndërtimeve)</i></b>  Konsiderohet çmontimi I impianteve industrial dhe prishja e komplet e ndërtesave me pajisje special ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi dhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve	Punimet e seksionit 1.PRISHJE + An01	A (0-20 milion)	1 054 053.35
NS - 4	<b><i>(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)</i></b> Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës I dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punimeve të ngjashme me to.  Konsiderohen vendosja në veper, mirëmbajtja dhe ristrukturimi I karpenerisë dhe punimeve prej druri,	Punime seksioni 4.PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI+ 5. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË + 13. PUNIME BOJATISJE + 14. ANALIZA JASHTE LISTE	A (0-20 milion)	5 650 637.82

	<p>të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akukustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me material të ndryshme</p>			
--	---	--	--	--

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licenën e shoqërisë, si më poshtë:

**- 1 (një) ing. Ndërtimi ( Profili ndërtim)**

Drejtuesi teknik duhet të jetë **Inxhinier Ndërtimi** shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm :

1. Kontratë pune
2. Diplomë universitare
3. Librezë pune
4. CV

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Drejtuesin teknik të punimeve)*

*Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.*

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit**

**26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

a. 1 (një) teknik ndërtimi

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose institucione ekuivalente
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional të lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licensuara/akredituar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalente
- Librezë pune

Referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit tekniku i ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.

b. 1 (një) Murator

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik .
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit **“Shtresë betoni C6/10”**; **“ Mur b/a t=21~30 cm, C16/20, h~4 m”** kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) murator i cili do të realizojë këto punime.

c. 2 (dy) Suvaxhinj

Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik .
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit **“Suva xokoli me granil e cemento te bardhe”**; **“ Suva me kapote lartesi mbi 8m”** kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 2 (dy) murator i cili do të realizojë këto punime.

d. 2 (dy) bojaxhinj

Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik .
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit **“Boje hidroplastike cilesi e larte”**; kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 2 (dy) bojaxhinj i cili do të realizojë këto punime.

e. 1 (një) hekurthyes

Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik .
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit **“F.V hekur betoni periodik  $\emptyset > 12 \text{ mm}$ ”**; kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) hekurthyes i cili do të realizojë këto punime.

f. 1 (një) karpentier

Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet :

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik .
- Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit *“Mure b/a t=21~30 cm, C16/20, h~4 m”*; kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) karpentier i cili do të realizojë këto punime.

g. 2 (dy) Shoferë

**Kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet :**

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi Aftësie Profesionale e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Leje drejtimi sipas kategorisë përkatëse
- Librezë pune

Kur mjeti është me qira për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet :

- Deklaratë nga operatori ekonomikë se në rast të shpalljes fitues do të paraqesë kontratë pune me shoferat të cilët detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Leje drejtimi (*Mos sjellja e kësaj kontrate apo dhe e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Lejes së Ndërtimit pas shpalljes fitues të këtij operatori përbën kusht për s’kualifikimin e tij nga procedura dhe shpalljen si operator jo korrekt nga Autoriteti Kontraktor*)

Bazuar në të gjithë zërat e punimeve sipas preventivit, për lëvizjen e materialeve të ndërtimit dhe punëtorëve kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 2 (dy) shofera për drejtimin e mjeteve.

h. 2 (dy) punonjës Specialist të Çertifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi.

D.P.I. Rënia nga lartësitë, punime në fasadë, etj sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 ” Për miratimn e rregullores ” Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizatë çertifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këto duhet të paraqitet çertifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i liçencuar/çertifikuar, çertifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.***

**Argumentimi** : Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve. Kërkesa që punonjësit të kenë “Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme)” të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë duke u bazuar në ligjin Nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe VKM – në Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier” Në kriterin mësipërcituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar **punonjës të specializuar/të kualifikuar** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët të tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash, lyerje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si më sipër si dhe numri i kërkuar për çdo specialist është minimumi i mundshëm për kryerjen e këtyre punimeve. Kërkesa e paraqitjes së “Diploma/certifikata/dëshmi të arsimit profesional” të lëshuara nga institucionet të akredituara buron nga zbatimi i Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu duke iu referuar preventivit të pasqyruar në DST parashikohen ngritje skelash dhe punime në to, në lartësi > 8 m Kjo kërkesë e AK lidhet me faktin se projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon “Boje hidroplastike cilesi e larte”, “Mure b/a t=21~30 cm, C16/20, h~4 m” si dhe “Suva me kapote lartesi mbi 8m” rënia nga një lartësi e tillë e individëve apo materialeve përbën rrezik shumë të madh për jetën dhe shëndetin e personave të pranishëm në kantier. Numri prej 2 (dy) punonjësish të cilët të kenë “Çertifikatë për Punimet në lartësi”, nënkupton se për realizimin e vëllimeve ndërtimore që ndodhen në preventiv.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër jo më pak se **20 (njëzetë)** punonjës të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit (duke përfshirë dhe stafin teknik të sipërcituar) nga data e zhvillimit të tenderit.

Për t’a vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore

- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 ku është kërkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 13 (trembëdhjetë) punonjës për të realizuar punimet, rrjedh nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si më poshtë vijon:

NR.	Nr. An.	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasia	Op.P unetori	Op Tot Punetori	Op. Maki neri	OP TOT MAKI NERI
<b>PUNIME NDERTIMI</b>								
<b>1. PRISHJE</b>								
2	2.426/5	Prishje mur betonarme	m3	3.0	16.30	48.9		0.0
1	2.426/9	Prishje suvatim I jashtem	m2	1731.0	1.31	2,264.1		0.0
3	2.426/10	Prishje trotuari ekzistues	m2	136.0	1.44	195.8		0.0
4	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	14.0	18.80	263.2		0.0
		<b>Shuma 1</b>	leke			<b>2,772.09</b>		<b>0.00</b>
<b>2. PUNIME BETON DHE B/A</b>								
5	2.130	Mure b/a t=21~30 cm, C16/20, h~4 m	m <sup>3</sup>	8.00	19.0	152.32	2.75	22.0
		<b>Shuma 2</b>				<b>152.32</b>		<b>22.00</b>
<b>3. PUNIME HEKUR BETONI</b>								
6	2.166/1a	F.V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	1.000	42.00	42.00	0.63	0.63
		<b>Shuma 3</b>				<b>42.00</b>		<b>0.63</b>
<b>4. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI</b>								
7	2.340	Suva xokoli me granil e cemento te bardhe	m <sup>2</sup>	136.0	3.50	476.00	0.16	21.8

		<b>Shuma 4</b>				<b>476.00</b>		<b>21.76</b>
		<b>5.PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË</b>						
8	2.196	H/izolim me emulsion bitumi dhe nje shkrese k katrama	m2	235.0	0.70	164.50	0.04	9.4
		<b>Shuma 5</b>				<b>164.50</b>		<b>9.40</b>
		<b>6. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE</b>						
9	2.523/1	F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	140.0	0.24	33.88		0.0
		<b>Shuma 6</b>				<b>33.88</b>		<b>0.00</b>
		<b>7. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>						
10	2.288	Trotuar me pllaka pa borduren e betonit	m2	140.0	2.4	336.00		0.0
		<b>Shuma 7</b>				<b>336.00</b>		<b>0.00</b>
		<b>8. PUNIME DHEU</b>						
11	2.25	Germim dheu themele e plinta me b> 2 m, ekskavator me goma 0.25 m3, shkarkimi ne toke	m3	224.0		0.00	0.067	15.0
		<b>Shuma 8</b>				<b>0.00</b>		<b>15.01</b>
		<b>9. UJESJELLES DHE KANALIZIM I JASHEM</b>						
12	2.575	Puse kontrolli 1x1x1.5m	cope	6.0	50.30	301.80		0.0
		<b>Shuma 9</b>				<b>301.80</b>		<b>0.00</b>
		<b>10. PUNIME SHTRESASH 2</b>						
13	2.261	Shtrese rere	m3	22.0	2.18	47.85		0.0
14	2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3	14.0	8.6	120.40	0.730	10.2
		<b>Shuma 10</b>				<b>168.25</b>		<b>10.22</b>
		<b>11. PUNIME SHTRESASH</b>						
15	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges perhapur e ngjeshur me makineri	m3	60.0	0.34	20.40	0.14	8.4
		<b>Shuma 11</b>				<b>20.40</b>		<b>8.40</b>
		<b>12. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT</b>						
16	1.124/p	Bordura betoni 12x25 cm	ml	140.0	0.66	92.40		0.0



		<b>Shuma 12</b>				<b>92.40</b>		<b>0.00</b>
		<b>13. PUNIME BOJATISJE</b>						
17	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	1731.0	0.36	623.16		0.0
		<b>Shuma 13</b>				<b>623.16</b>		<b>0.00</b>
		<b>14. ANALIZA JASHTE LISTE</b>						
18	An01	Prishje, prerje e konstruksioneve metalike	cope	3.0	10.00	30.00	9.40	28.2
19	An02	Shpim dhe ngjitje me rezine	cope	75.0	0.40	30.00		0.0
20	An03	Kontroll dhe saldime pllakash metalike te paneleve	op	120.0	1.07	128.40		0.0
21	An04	Suva me kapote lartesi mbi 8m	m2	1731.0	2.18	3,773.58	0.10	173.1
22	An05	Mburoje plastike me pufka	m2	320.0	0.40	128.00		0.0
23	An06	Mbushje me dhe te germuar	m3	108.0	0.50	54.00		0.0
		<b>Shuma 14</b>	leke			<b>4,143.98</b>		<b>201.29</b>
						<b>Shu ma totale op punet ori</b>	<b>9,326.78</b>	<b>Shu ma totale op mak ineri</b>
								<b>288.70</b>

3 muaj pune \* 22 ditë pune muaji = 66 ditë pune

66 ditë pune \* 8 orë pune dita = 528 orë pune

9326.78 ore totale pune punëtori / 528orë pune total = 17.66 punëtor = 18 punëtor

288.70 orë totale pune makineri / 528 ore pune total = 0.55 manovrator = 1 manovrator

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 (tre) muajt e fundit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

**2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues nga 7-15 ton	copë 3	Në pronësi ose me qira
Kamionçinë me kapacitet mbajtës dhe eksportues 3.5 ton	copë 2	Në pronësi ose me qira
Skelë inventari	216 m <sup>2</sup>	Në pronësi ose me qira
Vinc kulle 4-6 ton me manovrator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 0.25 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 2 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot	Copë 1	
Vibrator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Elektroorgano	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul ( kompresor) me vibrim	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Trapan	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kompresor dore	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Troko	Copë 1	Në pronësi ose me qira
Kokore	Copë 20	Në pronësi ose me qira
Kuti ndihme e shpejtë	copë 2	Në pronësi ose me qira

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :
  - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
  - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
  - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
  - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
  - e) Liçencë transporti;
  - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
  - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
  
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet :
  - a) Kontrata e qerasë sipas formës së kërkuar nga ligji (e noterizuar);
  - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
  - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS);
  - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
  - e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
  - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
  - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij;

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

**Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

*Konkretisht për mjetet :*

- Kamion vetëshkarkues nga 7-15 Ton i referohet analizës Nr. 2.426/5; 2.426/3;2.130;2.166/10;2.340;2.196;2.523/1;2.888;2.575;2.575;2.261;2.262;2.164/b;2.124/p;An04. sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Kamionçinë me kapacitet mbajtës dhe eksportues 3.5 ton i referohet gjithë zërave që kanë materiale ndërtimi për t'u çuar në vepër si dhe transportit të punëtorëve.
- Skelë inventari i referohet analizave Nr. 2.130 dhe An04. sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë.
- Vinc kullë 4-6 ton me manovrator i referohet analizave Nr. 2.166/1a; 2.340; 2.262; An04 . sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Eskavator 0.25 m3 i referohet analizës Nr. 2.25 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Eskavator 2 m3 i referohet analizës Nr. 2.164/1b sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Autobot i referohet analizës Nr. 2.164/1b sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Vibrator i referohet analizës Nr. 2.130 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Elektroorgano i referohet analizës Nr.2.196 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Rul ( kompresor ) me vibrim i referohet analizës 2.164/1b sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Trapan i referohet analizës An01 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Kompresor dore i referohet analizës An01 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Troko i referohet analizës An01 sasia e përcaktuar është në varësi të volumit të punës dhe koeficientëve përkatës në analizë
- Kokore i referohet mjeteve për mbrojtjen dhe sigurinë në punë si dhe numri i kërkuar i referohet numrit të fuqisë punëtore të kërkuar.
- Pajisje të ndihmës së shpejtë i referohet dhënies së ndihmës së shpejtë  
(Shënim: përcaktimi i aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

#### **Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:**

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”

“ Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: *“Pronari i çdo mjete transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjete i transportit do të mbetet në qarkullim.”*

Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 “ Për transportet rrugore” neni 5 parashikon shprehimisht se : *“Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës.”*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:**

- ISO 9001:2015      **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**
- ISO 14001:2015    **Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**
- ISO 45001:2018    **Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Çertifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht s’kualifikimi.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e

veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe**

funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**